



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr 39, date 24/05/2002

**PER  
MIRATIM PROJEKTESH NE FUSHEN E INFRASTRUKTURES  
NE QYTETIN E TIRANES**

Në mbështetje të nenit 19, pika 5 dhe 9, neni 32, gërma “dh” të ligjit Nr.8652, dt.31.07.2000, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore”, neni 18 të Ligjit Nr.7776 dt.22.12.1993 “Për buxhetin lokal në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me Ligjin 8399 dt.22.12.1998 “Për disa ndryshime në ligjin 7776 dt.22.12.1993”, të Ligjit Nr.7971, dt.26.07.1995 “Për prokurimin publik”, neni 8, pika 5 të Ligjit Nr.8767 dt.05.04.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime të Ligjit 7971 dt.26.07.1995 “Për prokurimin publik”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.4 dt.11.02.2002 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2002 për Bashkinë e Tiranës” dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.16, dt.11.03.2002 Mbi financimin e projektit “Rikonstruksion i segmentit rrugor të Rr. Së “Kavajës” nga “21 Dhjetori” deri tek Rr. “Irfan Tomini” dhe projektit “Rehabilitim, restaurim i fasadave në qytet”, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak

**V E N D O S I**

1. Të miratojë projektin “Sistemim, asfaltim, ndriçim pedonal, rikonstruksion trotuarësh, ujësjellës dhe zgjerim (në krahun e Lanës) i Bulevardit “Bajram Curri”, për segmentin nga Ura e “Elbasanit” tek “Brryli”, në shumën prej 80.000.000 lekë të shtrirë në dy vite

kalendarike, përrjedhojë dhe buxhetore, sipas preventivit bashkëngjitur

2. Të financohet projekti sipas pikës 1 të këtij vendimi, në shumën prej 60.000.000 lekësh nga buxheti i miratuar për vitin 2002 dhe në shumën prej 20.000.000 lekësh nga buxheti për vitin 2003
3. Fondi prej 60.000.000 lekë sipas pikës 2 të këtij vendimi, të përballohet nga buxheti i investimeve nga të ardhurat për vitin 2002, zëri “Zgjerim i rrugës në ët dy anët e Lanës nga Rruga e “Elbasanit” tek Brryli”
4. Të miratojë projektin “Sistemim, asfaltim, ndriçim i lartë dhe pedonal, rikonstruksion trotuarësh, ujësjellës dhe zgjerim i Rrugës së “Kavajës” për segmentin nga Sheshi “Ataturk” tek Ura pranë Shkollës Teknologjike”, në shumën prej 273.000.000 lekësh, të shtrirë në dy vite kalendarike, për rrjedhojë dhe buxhetore, sipas preventivit bashkëngjitur
5. Të financohet projekti, sipas pikës 4 të këtij Vendimi, në shumën prej 110.000.000 lekësh nga buxheti i miratuar për vitin 2002 dhe në shumën prej 163.000.000 lekësh nga buxheti për vitin 2003
6. Fondi prej 110.000.000 lekësh, sipas pikës 5 të këtij Vendimi, të përballohet nga buxheti i investimeve nga të ardhurat për vitin 2002, zëri “Rikonstruksioni i segmentit rrugor të Rr. së “Kavajës” deri tek Rr. “Irfan Tomini”
7. Të miratojë projektin “Sistemim, asfaltim, rikonstruksion trotuarësh, rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizime të Rrugës “Qemal Stafa”, për segmentin nga Unaza deri tek Sheshi “Shtraus” dhe segmentin –60 m para kryqëzimit të Rrugës “Q. Stafa” me Rr. “B. Curri” deri tek IKV”, në shumën prej 193.000.000 lekësh, të shtrirë në dy vite kalendarike, për rrjedhojë dhe buxhetore, sipas preventivit bashkëngjitur
8. Të financohet projekti, sipas pikës 7 të këtij Vendimi, në shumën prej 40.000.000 lekësh nga buxheti për vitin 2003
9. Fondi prej 40.000.000 lekësh, sipas pikës 8 të këtij vendimi, të përballohet nga buxheti i investimeve nga të ardhurat për vitin 2002, zëri “Rikonstruksioni i seg. në Rr. “Qemal Stafa”, nga Xhamlliku në Unazë dhe segmenti drejt IKV”

**10.**Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Ekonomike dhe Drejtoria e Prokurimit Publik për ndjekjen dhe zbatimin e këtij Vendimi

**11.**Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes

**KRYETARI**

**Leonidha TOSKA**